



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.1, 106.2, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenit 26 të Ligjit nr. 03/L-073 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 04.12.2009 nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 për Kryetarë të Komunave

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendotime dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) dhe nga Gjykata Kushtetuese, ***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 për Kryetar të Komunave si në vijim:***

Deçan, Gjakovë, Glogovc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpce, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveqan, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug dhe Kllokot.

- III. Në pajtim me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve nga pika I e këtij vendimi, Raundi i II-të i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave për kandidatët e subjekteve politike përkatëse do të organizohet me 13 dhjetor 2009 në komunat si në vijim:

Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prizren, Shtërpce, Suharekë, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik dhe Hani i Elezit.

- IV. Rezultatet e Zgjedhjeve si në pikën I i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Poashtu këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- V. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë në formë tabelare rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me 04.12.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve